



Funded by
the European Union



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS



MUZEU ETNOGRAFIK I KRUIJËS



CH
WB
Cultural
Heritage without Borders
ALBANIA







MUZEU ETNOGRAFIK I KRUJËS



Ky libërth është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CHwB Albania dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS-it.

CH
WB
Cultural
Heritage without Borders
ALBANIA

KE SHKUAR NDOJËHERË NË NJË MUZE ETNOGRAFIK?

Në një muze etnografik mësojmë sesi kanë jetuar më parë njerëzit. Të vizitosh një vend të tillë do të thotë të bësh një udhëtim pas në kohë, i cili na zgjon dëshirën për ta njohur sa më mirë dhe për të ruajtur trashëgiminë tonë kulturore.

Çdo vend ka trashëgiminë e vet të larmishme, e cila mund të jetë e prekshme, si ndërtesat apo objektet. Por ajo mund të jetë edhe shpirtërore, si këngët e vallet popullore, përrallat, dijet e prodhimit të veshjeve, ushqimeve, mjeteve të punës etj.

Zbulo më shumë për Muzeun Etnografik të Krujës dhe trashëgiminë e saj të veçantë në këtë libërth.



KËTA JANË DISA NGA MUZETË ETNOGRAFIKË NË SHQIPËRI.

Vendos emrin e qytetit te secili emërtim i muzeve etnografikë.
Kërko informacion nëse nuk i njeh të gjithë ata.

Kavajë | Krujë | Kukës | Vlorë
Berat | Gjirokastër | Elbasan | Durrës



Muzeu Etnografik i

Muzeu Etnografik i

Muzeu Etnografik i

Muzeu Etnografik i




Muzeu Etnografik i

Muzeu Etnografik i


Muzeu Etnografik i

Muzeu Etnografik i

Shtëpia e miqve
- Selamllëku



Shtëpia ku ndodhet sot Muzeu Etnografik i Krujës dallon shumë nga shtëpitë e tjera krutane. Dikur, pranë saj ndodhej një shtëpi tjetër e zbukuruar me piktura murale. Ajo quhej Shtëpia e Miqve, ndërsa ndërtesa ku sot ndodhet muzeu ishte shtëpia e familjes Toptani.



PAZARI I KRUJËS



Pazari ishte zemra e jetës së qytetit të Krujës. Aty mblidheshin tregtarë e banorë nga Kruja dhe fshatrat përreth.

Krutanët njihen si tregtarë të zotë, por në pazar ata nuk bënin vetëm tregti. Aty kalonin dhe kohën e tyre të lirë.

Sot, pazari i Krujës përveç se një pikë referimi për të gjithë qytetin, është shumë i njohur dhe nga turistët e huaj.



Në pazar mjeshtrat punonin objekte prej leshi, lëkure, druri e metali, sipas mënyrave tradicionale.

Disa nga objektet që ndodhen këtu NUK i përkasin pazarit të Krujës.

Gjej se cilët janë ata.

Në zonën e Krujës, burrat dhe gratë, në dyqan apo në shtëpi, i bënin vetë veshjet e tyre. Gratë endnin pëlhura të pambukta e të mëndafshta, ndërsa burrat qëndisnin pjesë të veçanta të kostumeve kombëtare.



Qeleshja është një nga objektet më të veçanta për shqiptarët. Krutanët i punonin ato me kujdes dhe shumë dashuri. Qeleshja ka forma e ndonjëherë dhe emra të ndryshëm, sipas krahinave të ndryshme të Shqipërisë.

Si quhen dhe çfarë forme kanë ato në krahinën tënde?



Këto janë disa objekte metalike që krutanët përdornin në jetën e përditshme, të cilat prodhoheshin nga kovaçët. Ata furnizonin qytetin dhe fshatrat me enë kuzhine, vegla pune për bujqit, si dhe objekte që përdornin barinjtë, si këmborë, patkonj etj.


Gjeji këto objekte në muze dhe emërtoji ato.

VJELJA E ULLINJVE



Kruja është e rrethuar nga ullishtet. Në vjeshtë krutanët i vjelin ullinjtë dhe kokrrat e tyre i grumbullojnë në kosha. Me to bëjnë vaj ulliri.

SHTYPJA E ULLINJVE



Dikur, vaji i ullirit mund të bëhej në shtëpi dhe në përpunimin e tij merrte pjesë e gjithë familja. Edhe në shtëpinë e Toptanëve që tashmë është muze bëhej vaj ulliri.

A e gjen dot se në cilën dhomë?



Dhoma më e zbukuruar e shtëpisë është ajo e nuses. Vetëm vajzat mund të rrinin në këtë dhomë. Si vajzat e shtëpisë që largoheshin dhe nuset e reja që vinin, festonin në këtë dhomë.

Ku ndryshon kjo dhomë nga dhomat e vajzave sot?



Edhe burrat kishin dhomën e tyre në shtëpi. Kjo dhomë ishte përherë e pastër dhe e rregullt dhe priste e përcillte miqtë. Dikur, miku ulej këmbëkryq pranë oxhakut, nga ana e djathtë.

Po ti, si i pret miqtë në shtëpinë tënde?

VESHJE TRADICIONALE

Këto veshje janë disa nga veshjet tradicionale të grave dhe burrave krutanë. Sa prej tyre mund të dallosh në muze?

Priti dhe ngjiti ato te figurat në të majtë.





Për shumë kohë, gratë krutane kanë endur pëlhura të mëndafshita e të pambukta. Më vonë, në Krujë filluan të punoheshin edhe qilimat. Gratë krutane i zbukurorin qilimat me motive të ndryshme.

Vazhdo ngjyrosjen e motiveve të këtij qilimi.

Mund ta gjesh se ku ndodhet në muze?

Do të të pëlqente të vishje një brez kaq të bukur
si ky që vishnin gratë e zonës së Kurbinit?

Ngjyrose atë.



PROFESIONISTËT E MUZEUT

Unë jam muzeologia. Organizoj dhe drejtoj muzeun në mënyrë që të gjithë të kënaqen.



Unë jam konservuesja. Kujdesem që objektet e muzeut të ruhen sa më mirë.



Unë jam ciceroni i muzeut. Unë u rrëfej vizitorëve të shumtë historinë dhe veçoritë e muzeut.



Unë jam kuratorja. Punoj që ekspozitat e muzeut të jenë sa më kuptimplota dhe njohëse.



**MUZEU ËSHTË NJË VEND PËR TË GJITHË...
PËRFSHIRË DHE DISA MIQ TË PAFTUAR.**

Unë jam miu
dhe më pëlqen
të ushqehem me
tekstile
dhe letër.

Unë jam
një larvë dhe më
pëlqen të ushqehem me
objektet prej druri,
prej leshi dhe prej
mëndafshi.

Ne jemi myqe
dhe na pëlqen të
strukemi kudo ku
ka lagështi.

ÇFARË BËJNË KONSERVUESIT?

Konservuesit ruajnë dhe mirëmbajnë objektet në një muze, si dhe mjedisin që i rrethon ata.

Ata mund të jenë specialistë të një materiali në veçanti, si p.sh. për leshin, mëndafshin, metalin, letrën, gurin etj.

Unë po bashkoj pjesët e një ene të thyer.

Unë po mas lagështinë e objekteve në muze.

TANI ERDHI RADHA JOTE TË PROVOSH PUNËN TONË.

Studio një objekt në muze dhe tregojë vizitorëve për të.

VIZATO OBJEKTIN E PREFERUAR NGA MUZEU.



Si quhet ky objekt?

Sa i vjetër është objekti?

Me çfarë materiali është bërë?

Prej nga vjen ky objekt?

Kush mund ta ketë bërë?

Kush mund ta ketë përdorur?

**ÇFARË TË LA MË SHUMË MBRESA
NGA VIZITA NË MUZE?**



ÇFARË DO DOJE TË SHIKOJE TJETËR NË MUZE?



FJALORTH

- ENDJE** gërshetimi i fijeve në vegjë për të bërë pëlhurë.
- KONSERVIM** ruajtja dhe mirëmbajtja e objekteve në një muze.
- KOVAÇ** punëtor që farkëton hekurin për të bërë vegla të ndryshme, hekurpunues.
- MOTIV** një figurë ose imazh zbukurimor në një objekt a në një veshje që zakonisht përsëritet.
- PAZAR** një vend me dyqane e punishte, ku njerëzit mblidhen për të shitur e blerë sende, mallra e ushqime që u nevojiten.
- PËLHURË** copë e endur hollë zakonisht me fije pambuku a mëndafshi, që përdoret për veshje të lehta, për mbulesa.
- QELESHE** kësulë e bardhë, e rrumbullakët, e cila ka forma e përmasa të ndryshme sipas krahinave.
- QILIM** shtrojë leshi ose pambuku me përmasa të ndryshme dhe me një a me disa fletë, e punuar në vegjë, zakonisht me zbukurime shumëngjyrëshe.
- RESTAURIM** ndërhyrjet me qëllim plotësimin dhe jetëgjatësinë e objekteve e monumenteve që janë pjesë e trashëgimisë sonë kulturore.

- SHAJAK** veshje (zhgun) leshi i trashë e zakonisht i ashpër, mjaft i përdorur në veshjet tradicionale shqiptare.
- TJERRJE E LESHIT** e bëj fill leshin, pambukun, lirin etj., duke e tërhequr pak nga pak nga shtëllunga dhe duke e dredhur me dorë dhe me makinë.
- TRASHËGIMIA KULTURORE** tërësia e objekteve, veshjeve, ndërtesave, këngëve e traditave të cilat përcillen nga njëri brez në tjetrin.
- TRASHËGIMI KULTURORE E PREKSHME** objektet materiale të trashëguara brez pas brezi, të cilat kanë vlerë të madhe për ne (objektet dhe ndërtesat e vjetra, veshjet tradicionale etj).
- TRASHËGIMI KULTURORE SHPIRTËRORE** tërësia e këngëve, valleve, historive dhe traditave të vjetra që përcillen nga njëri brez në tjetrin.
- VEGËL** mjet i thjeshtë që shërben për të kryer një punë.
- VESHJE TRADICIONALE** veshje që punohen me teknika e metoda të vjetra.
- ZEJE** mjeshtëria që ushtron dikush përditë, zakonisht duke punuar me dorë a me vegla të thjeshta, duke pasur shprehi e aftësi të posaçme, të fituara nga përvoja.

SITET E TJERA EU4CULTURE NË SHQIPËRI



Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë



Teatri Kombëtar i Kukullave, Tiranë



Ministria e Kulturës, Tiranë



Muzeu Arkeologjik, Durrës



Muzeu Etnografik, Durrës



Hamami, Durrës



Torra Veneciane, Durrës



Ndërtesa e Institutit të ish të Përndjekurve Politikë



Kisha e Shën Ndojt, Rodon



Muzeu Etnografik, Krujë



Ura e Kurçajt, Krujë



Kisha e Manastirit Rubik



Rrënojat e Kishës së Shën Mërisë, Mamurras



Kalaja në Ishëm



Kalaja e Lezhës



Ish-Aqripeshkvia, Laç



Muzeu Etnografik, Kavajë



Kalaja e Bashtovës, Rrogozhinë

NË TË NJËJTIN GJERDAN LIBËRTHASH DO TË GJENI



GJERDANI I LIBËRTHAVE, PJESË E SË CILIT ËSHTË DHE KY BOTIM, ËSHTË PJESË E PROJEKTIT ‘PLATFORMAT E FUQIZIMIT DHE TË MËSIMIT PËRMES TRASHËGIMISË’ TË FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NË KUADËR TË PROGRAMIT EU4CULTURE, TË ZBATUAR NGA UNOPS-I NË KOORDINIM ME MINISTRINË E KULTURËS.

Ky projekt, i cili u zbatua nga CHwB Albania, mundësoi realizimin e katër libërthave për fëmijë mbi Muzeun Etnografik të Kavajës, Muzeun Etnografik të Krujës, Urën e Kurçajt (Krujë) dhe Kalanë e Bashtovës (Rrogozhinë). Këto libërtha u bashkëkrijuan me përfaqësues nga institucionet publike vendore e qendrore, profesionistë e qytetarë aktivë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore nga qytetet përkatëse. Qëllimi i këtyre libërthave është forcimi i njohurive të fëmijëve të moshave 6 - 11 vjeç mbi disa prej vlerave më të veçanta të trashëgimisë sonë kulturore, si dhe të shërbyerit si mbështetje për aktivitete praktike pranë siteve të përmendur e jo vetëm, që kanë trashëgiminë kulturore në fokus.



Muzeu Etnografik i Krujës

Botues: Cultural Heritage without
Borders Albania (CHwB Albania)

Koncepti: Mirian Bllaci, Arnold Kapinova, Fatime Paja
Konsulentë për materialin etnografik: Nurmira Ricaj,
Afërdita Onuzi

Konsulente për tekstin dhe redaktimin: Luljeta Dano,
Rudina Çupi.

Ilustrimet: Fatime Paja (Trivet)
Përpunimi grafik, faqosja: Fatime Paja (Trivet)
Drejtues projekti: Mirian Bllaci

ISBN: 978-9928-801-04-3

Ky libërth është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit
Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CHwB Albania dhe
nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose
UNOPS-it.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Muzeu Etnografik i Krujës / koncept.

Mirian Bllaci, Arnold Kapinova, Fatime

Paja ; il. Fatime Paja (Trivet) ; red. e konsult.

Luljeta Dano, Rudina Çupi. - Tiranë : Cultural

Heritage without Borders Albania, 2023

56 f. : me il. ; 25 x 25 cm.

ISBN: 978-9928-801-04-3

1.Etnologjia shqiptare 2.Muze 3.Botime për fëmijë

4.Shqipëri

078.5 :069(496.5)





